

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
 NËNËLLI PROKURORIALI KOSOVËS - TIPIK AKADEMIA KOSOVA
 SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT
 ARKIVA - ARHIVA

Pranuar 26 -02- 2024 Primtjeto

Numri rendor Redni broj	Ora e pranimit Ças prijema	Nenshkrimt i pranuesit Potpis primaoca
368		



Raporti i punës së Prokurorisë Themelore në Pejë për vitin 2023



Falënderim



Dinamika e punës në vitin 2023 në Prokurorinë Themelore të Pejës, ka sjellë rezultate të mira, këtë e dëshmojnë edhe të dhënat e pasqyruara në Raportin e Punës të kësaj prokurorie për vitin 2023.

Jë gjitha këto punë, statistika dhe rezultate pozitive nuk do ishin arritur pa angazhimin e të gjithë prokurorëve dhe mbështetjen e palodhshme të stafit mbështetës, në veçanti shkrimores, bashkëpunëtorëve profesional zyrtarëve ligjor dhe sekretareve juridike.

Ju faleminderit për kontributin dhe përgjegjësin e treguar gjatë punës në vitin 2023. Uroj që ky përkushtim të na përcjellë edhe në vitet në vijim.

*Kryeprokurori
Dr.sc. Agim Kurmehaj*

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave të përdorura	3
H Y R J E	4
1. Numri i prokurorëve	5
2. Plani i punës për vitin 2023 për Prokurorinë Themelore në Pejë.....	6
3. Të arriturat e Prokurorisë Themelore në Pejë gjatë vitit 2023	7
3.1. Performanca e PTH-Pejë, në lidhje me rastet e dhunës në familje për vitin 2023.....	11
3.2. Performanca e PTH-Pejë në lidhje me veprat penale karakteristike për vitin 2023.....	11
3.2.1. Efikasiteti me lëndët KORR	11
3.2.2. Efikasiteti me lëndët DR	13
3.2.3. Efikasiteti me lëndët NU	15
3.2.4. Efikasiteti me lëndët E	15
3.2.5. Efikasiteti me lëndët TNJ	16
3.2.6. Efikasiteti me lëndët KM	17
3.3. Degradimi i ambientit veçanërisht pyjeve.....	18
3.3.1. Strategjia e veprimit:	18
3.3.2. Të arriturat:.....	20
3.4. Sekuestrimet e përkohshme, ngrirjet e aseteve dhe konfiskimet	20
3.5. Zgjidhja e rasteve me procedurat alternative	21
4. Gjendja e rasteve në regjistrin PPN	22
5. Gjendja e rasteve në regjistrin PPP	22
6. Gjendja e rasteve në regjistrin NJN	23
7. Zbatimi i SMIL-it PTH – Pejë	24

Lista e shkurtesave të përdorura

- DKR – Departamenti i Krimeve të Rënda
- DM – Departamenti për të Mitur
- DP – Departamenti i Përgjithshëm
- PTH-Pejë – Prokuroria Themelore në Pejë
- KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës
- KORR – Korrupsion
- NU – Nxitje e urrejtjes
- DR – Droga
- TNJ – Trafikim me qenie njerëzore
- E - Ekonomi
- PP – Regjistri me kryerës të njohur të veprave penale
- PPP – Regjistri me kryerës të pa njohur të veprave penale
- PPN – Regjistri me lëndë të ndryshme
- PPM – Regjistri me kryerës të mitur
- NJN – Ndihmë juridike ndërkombëtare

H Y R J E

Konform dispozitave ligjore, Prokurori i shtetit siguron dhe publikon informacione dhe të dhëna për aktivitetet e realizuara gjatë vitit.

Ky raport përmban aktivitet kryesore të Prokurorisë Themelore në Pejë për vitin 2023, me fokus të veçantë në punën e kryer gjatë këtij viti përmes të dhënave statistikore dhe krahasimi i tyre me vitin e kaluar në ato raste ku ishte e mundur.

Raporti i punës posedon informacionet e përgjithshme për Prokurorinë Themelore në Pejë, përfshirë numrin e prokurorëve për këtë periudhë, në raport përfshihen kallëzimet penale të trashëguara nga viti i kaluar, ato të pranuar gjatë kësaj periudhe, lëndët e përfunduara, rastet e zgjidhura me procedurat e alternative, zbatimin e konfiskimit dhe sekuestrimit dhe ngrirjes së aseteve, rastet me veprat penale karakteristike dhe çështje tjera me rëndësi.

Po ashtu janë përmendur lëndët e kryera dhe të pranuar për secilin departament veç e veç.

Edhe përkundër faktit se Prokuroria Themelore në Pejë gjatë vitit 2023 është ballafaquar me sfida të shumta, konsiderojmë se janë arritur rezultate të kënaqshme dhe është tejkaluar norma vjetore e përcaktuar nga KPK-ja.

1. Numri i prokurorëve

Në fillim të periudhës raportuese Prokuroria Themelore në Pejë, në muajin Janar të vitit 2023, kishte gjithsej pesëmbëdhjetë prokuror (15) duke përfshirë edhe Kryeprokurorin. Pesë (5) prej tyre ushtrojnë detyrën në Departamentin e Krimeve të Rënda, dy (2) në Departamentin për Mitur dhe shtatë (7) në Departamentin e Përgjithshëm.

	Dep. Krimeve të Rënda	Dep. për të Mitur	Dep. Përgjithshëm
	Agron Galani (i pensionuar me dt. 09.11.2023)	Sanije Gashi-Seferi	Dorjan Juniku
	Valbona Disha-Haxhosaj	Suada Hamza	Lumturije Hoxha
	Lumturije Vuçetaj		Ramiz Buzhala (i Transferuar nga PTH-Gjakovë me dt. 01.03.2023)
	Sahide Gashi		Sadije Muriqi (Pushim Lehonie deri me dt. 10.10.2023)
	Ardian Hajdaraj (Anëtar i KPK-së)		Ardiana Veseli
	Ersan Qavolli		Arlinda Nallbani-Gacaferi
			Ermal Demhasaj (Dekretuar si Prokuror me dt. 15.03.2023)
			Taulant Atashi (I dorëhiqur me dt. 31.08.2023)
Totali	5	2	7

Tabela me prokurorët të vitit 2023

Në Departamentin e Përgjithshëm deri në muajin Tetor të drejt pranimi të lëndëve kishin vetën pesë (4) prokuror, Në fund të periudhës raportues kësaj prokurorie i janë shtuar edhe dy (3) prokuror, njëri prej tyre Prokuror i dekretuar rishtas me dt. 15.03.2023, një Prokuror i transferuar nga PTH-Gjakovë në muajin Mars 2023, ndërsa me dt. 10.10.2023, nga pushimi i Lehonisë është kthyer një Prokurore, gjersa me dt. 31.08.2023, është dorëhequr një Prokuror.

2. Plani i punës për vitin 2023 për Prokurorinë Themelore në Pejë

Plani i punës së PTH-Pejë për vitin 2023 është përmbledhë në disa objektiva siç janë:

- Lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike;
- Trafikimi me qenie njerëzore;
- Trafikimi me narkotik;
- Dhuna në familje;
- Bashkëpunimi ndërinstitucional;
- Sekuestrimi dhe ngrirja; dhe
- Zbatimi i SMJL-it.

Gjatë kësaj periudhe edhe përkundër sfidave të shumta të cilat janë paraqitur, kemi arritur që t'i realizojmë një pjesë të pikat e lartcekura madje në disa raste edhe i kemi tejkalluar pritjet tona. Për më shumë në lidhje me zbatimin e planit të punës do të flitet më poshtë. Vlen të ceket se të arriturat e PTH-Pejë gërshetohen me planin e sipërshtuar i cili gjen mbështetje edhe në planin e punës së Prokurorisë së Shtetit për këtë vit.

3. Të arriturat e Prokurorisë Themelore në Pejë gjatë vitit 2023

Nga 01.01.2023 e gjerë 31.12.2023 PTH-Pejë ka pranuar gjithsej 2928 kallëzime penale kundër 3735 personave. Në DKR janë pranuar 124 kallëzime kundër 226 personave, në DM 182 kallëzime penale kundër 274 personave dhe në DP janë pranuar 2622 kallëzime penale kundër 3,235 personave.

Departamenti	Të Pranuara	Persona
D.K.R.	124	226
D.M.	182	274
D.P.	2622	3,235
Gjithsej	2928	3735

Tabela e lëndëve të pranuar PP

Kjo prokurori nga vitet paraprake ka bartur 978 lëndë në regjistrin PP kundër 1539 personave, prej tyre DKR ka bartur 105 lëndë kundër 270 personave, DM 24 lëndë kundër 39 personave dhe DP 849 lëndë kundër 1,230 personave.

Departamenti	Të bartura	Persona
D.K.R.	105	270
D.M.	24	39
D.P.	849	1,230
Gjithsej	978	1,539

Tabela e lëndëve të bartura në vitin 2023 në regjistrin PP

PTH-Pejë së bashku me lëndët e pranuar dhe ato të bartura, në regjistrin PP gjatë kësaj periudhe kishte në punë 3906 lëndë kundër 5,274 personave, përkatësisht DKR kishte në punë 229 lëndë kundër 496 personave, DM 206 lëndë kundër 313 personave dhe DP 3,471 lëndë kundër 4,465 personave.

Departamenti	Në punë	Persona
D.K.R.	229	496
D.M.	206	313
D.P.	3,471	4,465
Gjithsej	3,906	5,274

Tabela me numrin e lëndëve viti 2023 në punë PP

Sa i përket lëndëve të pranura në regjistrin PP, Policia e Kosovës, ka parashtruar 2,341 kallëzime penale kundër 3,005 personave, **të tjerët** (qytetares, KEDS, DAPK, Komuna, AKK etj...) **555 kallëzime penale** kundër 689 personave, nga kompetenca 14 lëndë kundër 14 personave dhe me vetiniciativë 18 lëndë kundër 27 personave.

Parashtruesit	Lëndë	Persona
Policia	2,341	3,005
Të tjera: qytetarët, KEDS, DAPK, Komuna, AKK etj...	555	689
Nga kompetenca	14	14
Vetiniciativë	18	27
Gjithsej	2928	3735

Parashtruesit e kallëzimeve në regjistrin PP

Gjatë kësaj periudhe kohore në regjistrin PP janë përfunduar 2844 lëndë kundër 3868, ashtu që DKR janë kryer 168 lëndë kundër 369 personave, në DM 188 raste kundër 284 personave, ndërsa në DP 2487 lëndë kundër 3,215 personave.

Departamenti	Të përfunduara	Persona
D.K.R.	168	369
D.M.	188	284
D.P.	2487	3,215
Gjithsej	2843	3868

Tabela e lëndëve të përfunduara PP

Siç u pa më lart gjithsej janë përfunduar 2843 lëndë prej të cilave **1969 aktakuza**, 114 pushime hetimeve, kallëzimi penal është hedhur për 539 raste, në kompetencë janë dërguar 54 lëndë, për 44 raste është parashtruar propozimi për masë edukative, për 13 raste është pushuar procedura përgatitore, masa e diversitetit është shqiptuar për 54 raste, në 53 raste nuk është filluar procedura përgatitore, në 1 rast është bërë propozimi për shqiptimin e masës institucionale. Vlen të ceket se edhe për 2 raste është marrë aktvendimi për pezullimin e hetimeve për shkak të pengesave procedurale, e të cilat lëndë konsiderohen si të pa kryera.

	Aktakuza	Pushim i hetimeve	Pezullim i hetimeve	Hedhje e kallëzimit penal	Kompetencë	Propozim për shqiptimin e masës edukative	Pushim i procedurës përgatitore	Masa e diversitetit	Mosëfillim i procedurës përgatitore	Propozim për shqiptimin e masës institucionale	Masë trajtimit të detyrueshëm psikiatrikë	Gjithsej
Lëndë	1969	114	2	539	47	44	13	54	53	1	0	2843
Persona	2621	190	2	723	75	51	40	75	83	1	0	3861

Mënyra e përfundimit të lëndëve

Prej 168 lëndëve të përfunduara në DKR janë ngritur 97 aktakuza, për 29 raste janë pushuar hetimet, kallëzimi penal është hedhur për 18 lëndë, 24 tjera janë dërguar në kompetencë.

Në DM janë përfunduar 188 lëndë, prej të cilave për 44 raste është bërë propozimi për shqiptimin e masës edukative, për 13 raste është pushuar procedura përgatitore, 16 kallëzime penale janë hedhur poshtë, në 54 raste është shqiptuar masa e diversitetit, në 53 raste nuk është filluar procedura përgatitore, 7 janë dërguar në kompetencë dhe për 1 raste është bërë propozimi për shqiptimin e masës institucionale.

Në DP janë përfunduar 2487 lëndë prej të cilave janë ngritur 1872 aktakuza, për 85 raste janë pushuar hetimet, kallëzimi penal është hedhur për 505 raste, 23 lëndë janë dërguar në kompetencë Po ashtu për 2 raste për shkak të pengesave procedurale është pezulluar hetimi.

	Aktakuza	Pushim i hetimeve	Pezullim i hetimeve	Hedhje e kallëzimit penal	Kompetencë	Propozim për shqiptimin e masës edukative	Pushim i procedurës përgatitore	Masa e diversitetit	Mosëfillim i procedurës përgatitore	Propozim për shqiptimin e masës institucionale	Masë trajtimit të detyrueshëm psikiatrikë	Gjithsej
D.K.R.	97	29		18	24							168
D.M.				16	7	44	13	54	53	1		188
D.P.	1872	85	2	505	23							2487

Mënyra e përfundimit në secilin departament

Të pa kryera në fund të periudhës raportuese kanë mbetur 1063 lëndë kundër 1406 personave ashtu që, në DP janë 984 lëndë kundër 1250 personave, në DM 18 kundër 29 personave dhe në DKR 61 lëndë kundër 127 personave. Siç u potencua më lart, në numrin e lëndëve të pa kryera janë edhe 2 rastet e pezullimit të hetimeve për të cilat janë paraqitur pengesat procedurale për vazhdim të mëtuqjeshëm.

	D.K.R.	D.M.	D.P.	Gjithsej
Të pa kryera	61	18	984	1063
Persona	127	29	1250	1406

Tabela e lëndëve të pa kryera

Bazuar në të lartcekurat dhe faktin se gjatë kësaj periudhe kishim në punë 3,906 lëndë PP gjersa janë kryer 2,843 dhe kanë mbetur në punë 1,063 lëndë, gjejmë se 73% e lëndëve janë përfunduar.

3.1. Performanca e PTH-Pejë, në lidhje me rastet e dhunës në familje për vitin 2023

Gjatë vitit 2023, Prokurori koordinator (Lumturije Hoxha) ka pranuar gjithsej 354 kallëzime penale të rasteve të dhunës në familje, ndërsa nga viti paraprak janë bartur 22 lëndë që do të thotë se gjatë vitin në punë ishin gjithsej 376 lëndë. Nga ky numër i lëndëve janë kryer gjithsej 364 lëndë prej të cilave janë ngritur 355 Aktakuza, për 8 lëndë është marrë Aktvendim për hüdhe të kallëzimeve penale, ndërsa 1 lëndë është përfunduar me Aktvendim për pushimin e hetimeve.

Viti	Aktakuza	Pushim i hetimeve	Hedhje e kallëzimit penal	Gjithsej	Të pa kryera
2023	355	1	8	364	12

3.2. Performanca e PTH-Pejë në lidhje me veprat penale karakteristike për vitin 2023

Veprat penale karakteristike janë ato raste të cilat trajtohen me prioritet dhe atë: çështjet e Korrupsionit (KORR), nxitje urrejtjes (NU), drogës (DR), ekonomisë (E) dhe trafikimit me njerëz (TNJ), PTH-Pejë për këtë periudhë kohore performancën në lidhje me këto çështje e ka sikur më poshtë.

3.2.1. Efikasiteti me lëndët KORR

PTH-Pejë në vitin 2023 në lidhje me lëndët KORR ka pranuar 36 kallëzime penale kundër 80 personave. Prej këtyre rasteve policia ka parashtruar 14 kallëzime penale kundër 24 personave, prej të cilave 11 kallëzime penale nga

neni 414 të KPRK-së kundër 21 personave, nga neni 421 të KPRK-së 1 kallëzim penal kundër 1 personi, nga neni 422 të KPRK-së 2 lëndë kundër 2 personave. Nga AKK kemi pranuar 5 kallëzime penale kundër 5 personave, të gjitha për vepër penale neni 430 të KPRK-së. Nga të tjerët është pranuar 8 kallëzim penal kundër 12 personave për shkak të veprës penale nga neni 414 të KPRK-së. Ndërsa nga kompetenca janë pranuar 9 kallëzime penale kundër 39 personave dhe atë nga neni 414 të KPRK-së.

Parashtruesit	Lëndët	Persona
Policia	14	24
AKK	5	5
Të tjerët	8	12
Kompetence	9	39

Nga viti 2022 në vitin 2023 janë bartur 20 lëndë kundër 35 personave, ashtu që PTH-Pejë gjatë periudhës raportuese kishte në punë gjithsej 56 lëndë kundër 115 personave.

	Lëndët	Persona
Të bartura	20	35
Të pranuar	36	80
Gjithsej	56	115

Gjatë kësaj periudhe në regjistrin PP janë përfunduar 31 lëndë kundër 46 personave.

	Lëndët	Persona
Aktakuza	12	22
Pushim i het.	5	6
Hedhje e k.p.	12	16
Kompetencë	2	2
Gjithsej	31	46

Mënyra e përfundimit të lëndëve KORR

PTH-Pejë prej lëndëve të përfunduara janë ngritur 12 aktakuza kundër 22 personave. Prej aktakuzave të ngritura për vepër penale nga neni 414 të KPRK-

së, janë 6 raste kundër 15 personave, për vepër penale nga neni 422 të KPRK-së, 3 raste kundër 3 personave dhe për vepër penale nga neni 430 të KPRK-së, 3 raste kundër 3 personave.

Kjo prokurori ka hedhur 12 kallëzime penale kundër 16 personave për vepër penale nga neni 414 të KPRK-së.

Gjatë kësaj periudhe në lidhje me këto vepra penale janë pushuar hetimet për 5 raste kundër 6 personave, prej të cilave 4 raste kundër 5 personave janë, për vepër penale nga neni 414 të KPRK-së, gjersa 1 raste kundër 1 personi për vepër penale nga neni 437 të KPRK-së.

Ne vitin 2023 ne kompetence janë dërguar 2 KP kundër 2 personave dhe atë nga neni 430 të KPRK-se.

Në fund të vitit 2023 si lende të pakryera kane mbetur 25 KP kundër 69 personave.

Sa i përket regjistrit PPN në lidhje me lëndët e kësaj natyre nga vitet paraprake janë bartur 44 lëndë gjersa janë pranuar 69 që do të thotë në punë ishin 113 lëndë ndërsa janë përfunduar 58 raste, prej të cilave 46 lëndë janë mbyllur me shënim zyrtar dhe 12 janë dërguar në kompetencë. Për vitin 2024 janë bartur 55 lëndë.

3.2.2. Efikasiteti me lëndët DR

Në fillim të vitit janë mbajtur takime me Drejtoria për hetimin e trafikimit me narkotik në Pejë¹ për çka edhe janë caktuar prioritetet për vitin 2023 dhe aktivitetet e përbashkëta. Disa nga prioritetet kryesore kanë qenë ngritja e vetëdijesimit të të rinjve për efektet e dëmshme të narkotikëve, madje në këtë drejtim janë mbajtur edhe disa ligjërata në bashkëpunim me Policinë e Kosovës nëpër shkolla të ndryshme të qytetit të Pejës. Prioritet kryesor ka qenë dhe mbetet hetimit dhe ndjekja e shpërndarësve dhe shitësve të narkotikëve, me theks të veçantë afër dhe në institucionet arsimore-shëndetësore dhe qendrave korrektuese.

PTH-Pejë gjatë vitit 2023 në lidhje me veprat penale në regjistrin DR ka pranuar 108 kallëzime penale kundër 133 personave, të gjitha të parashtruar nga

¹ Në vazhdim DHTN.

Policia e Kosovës, ndërsa nga viti 2022 janë bartur 46 lëndë kundër 84 personave që do të thotë gjatë kësaj periudhe në lidhje me këto vepra kishim në punë 154 lëndë kundër 217 personave. Sa u përket veprave penale për të cilat janë pranuar kallëzimet penale janë 90 raste kundër 107 personave për vepër penale nga neni 269 të KPRK-së dhe 18 kallëzime penale kundër 26 personave për vepër penale nga neni 267 të KPRK-së.

	Lëndë	Persona
Të pranuar	108	133
Të bartura	46	84
Gjithsej	154	217

Vepra penale	Lëndët	Persona
v.p. 269	90	107
v.p. 267	18	26

Veprat penale për të cilat janë parashtruar kallëzimet penale

Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar 96 lëndë kundër 147 personave gjersa për vitin 2024 janë bartur 58 lëndë kundër 70 personave

Prej lëndëve të përfunduara janë **ngritur 91 aktakuza** kundër 121 personave, 3 pushim i hetimeve kundër 14 personave, 1 kallëzime kundër 11 personave është hedhur poshtë dhe 1 KP kundër 1 personi është dërguar në kompetencë.

	Lëndët	Persona
Aktakuza	91	121
Pushim i het.	3	14
Hedhje e k.p.	1	11
Kompetenë	1	1
Gjithsej	96	147

Mënyra e përfundimit

Kallëzimi penal është hedhur për 1 raste kundër 11 personave për vepër penale nga neni 269 të KPRK-së, ndërsa lidhur me pushimet e hetimeve, janë 3 raste kundër 14 personave dhe atë për vepër penale nga neni 269 të KPRK-së kemi 1 KP kundër 2 personave dhe nga neni 267 janë 2 KP kundër 12 personave.

Sa i përket aktakuzave, 75 raste kundër 95 personave janë për vepër penale nga neni 269 të KPRK-së dhe 16 raste kundër 26 personave për vepër

penale nga neni 267 të KPRK-së. Në kompetencë është barte 1 KP kundër 1 personi. Te pakryera ne fund te vitit 2023 kane mbetur 25 KP kundër 65 personave.

Sa i përket regjistrit PPN në lidhje me veprat penale të kësaj natyre nga vitet e kaluara janë bartur 44 raste gjersa janë pranuar 69 raste që do të thotë se në punë ishin 113 lëndë, ndërsa janë përfunduar 58 lëndë ashtu që për vitin 2024 janë bartur 55 raste.

3.2.3. Efikasiteti me lëndët NU

Nga vitin 2022 janë bartur 2 KP kundër 2 personave, ndërsa gjatë vitit 2023 nuk është pranuar asnjë kallëzim penal. Pra në punë gjatë këtij viti kanë qenë 2 KP kundër 2 personave nga neni 147 KPRK-se dhe është kryer 1 KP kundër 1 personi nga neni 147, ndërsa për vitin 2024 është bartur 1 KP kundër 1 personi.

Sa i përket regjistrit PPN nga viti 2022 nuk është bartur asnjë kallëzim penal, gjatë viti 2023 është pranuar 1 rast kundër 1 personi i cili është kryer po gjate këtij viti.

	Lëndë	Persona
Të pranuar	0	0
Të bartura	2	2
Në punë	2	2

	Lëndë në punë	Të përfunduara	Të pa kryera
Numri	2	1	1
Persona	2	1	1

3.2.4. Efikasiteti me lëndët E

PTH-Pejë gjatë vitit 2023 në lidhje me veprat penale në regjistrin E ka pranuar 33 kallëzime penale kundër 43 personave, prej këtyre lëndëve policia e Kosovës ka parashtruar 16 raste kundër 19 personave, Dogana e Kosovës ka

parashtruar 3 raste kundër 3 personave, ATK-ja 13 raste kundër 6 personave, nga IPK kemi pranuar 1 lëndë kundër 5 personave

Nga vitet paraprake janë bartur 37 lëndë të kësaj natyre kundër 63 personave, që do të thotë se në punë ishin 70 raste kundër 106 personave.

	Lëndët	Persona
Të pranuar	33	43
Të bartura	37	63
Gjithsej	70	106

Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar 33 lëndë kundër 49 personave gjersa

	Lëndë në punë	Të përfunduara	Të pa kryera
Raste	70	33	37
Persona	106	49	57

Prej lëndëve të përfunduara janë ngritur 21 aktakuza kundër 36 personave, 7 pushime të hetimeve kundër 8 personave dhe 5 kallëzime penale kundër 5 personave janë hedhur.

	Lëndët	Persona
Aktakuza	21	36
Pushim i het.	7	8
Hedhje e k.p.	5	5
Gjithsej	33	49

Mënyra e përfundimit të këtyre lëndëve

Lidhur me regjistrin PPN për lëndët e kësaj natyre nga vitet paraprake janë bartur 32 lëndë dhe janë pranuar 55 raste, pra në punë ishin 87 lëndë, prej të cilave janë përfunduar 55, ashtu që për vitin 2024 janë bartur 32 raste.

3.2.5. Efikasiteti me lëndët TNJ

PTH-Pejë gjatë vitit 2023 në lidhje me veprat penale në regjistrin TNJ ka pranuar 9 kallëzime penale kundër 12 personave, të parashtruara nga Policia e

Kosovës, nga neni 171, gjersa nga vitet paraprake nuk ka pasur raste të bartura në këtë vit, ashtu që gjatë vitit 2023 janë kryer 6 KP kundër 9 personave prej të cilave janë ngritur 5 akuza kundër 6 personave nga neni 171 dhe 1 KP kundër 3 personave është dërguar në kompetencë dhe në hetime kanë mbetur 3 KP kundër 3 personave.

	Lëndët	Persona
Të bartura	0	0
Të pranuar	9	12
Gjithsej	9	11

	Lëndë në punë	Të përfunduara	Të pa kryera
Numri	9	6	3
Persona	12	9	3

	Lëndët	Persona
Aktakuza	5	6
Kompetence	1	3
Gjithsej	6	9

Në lidhje me regjistrin PPN në vitin 2023 nuk është bartur asnjë rast dhe nuk është pranuar asnjë rast.

3.2.6. Efikasiteti me lëndët KM

Në vitin 2023 është bartur 1 KP kundër 1 personi nga neni 164 gjatë kësaj periudhe nuk kemi pranuar asnjë rast dhe në hetime ka mbetur 1 KP kundër 1 personi.

Sa i përket regjistrit PPN-KM të bartur nga viti paraprak kemi 1 rast i cili akoma është në hetime. Raste të reja nuk kemi pas.

3.3. Degradimi i ambientit veçanërisht pyjeve

3.3.1. Strategjia e veprimit:

Çështja e mbrojtjes së ambientit, veçanërisht zonave të veshura me pyje ishte njëra prej pikave të strategjisë së veprimit e përfshirë në planin e punës në Prokurorinë Themelore në Pejë qysh nga viti 2019 dhe vitet pasuese. Nëpërmjet kësaj strategjie është synuar dhe arritur koordinimi i veprimeve të institucioneve përkatëse ligj-zbatuese Prokurori-Polici-Agjensioni pyjor i Kosovës-DAPK.

Brenda kompetencës territoriale të Prokurorisë Themelore në Pejë ndodhet një territor i gjerë i veshur me pyje një pjesë e konsiderueshme në pronësi të shtetit, gjersa pjesa tjetër në pronësi private.


Vetëm Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” – përfshin sipërfaqen prej 62.488 ha. i cili shtrihet në territorin e komunave: Gjakovë, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog, e i cili fillon në pjesën jugore, në afërsi të pikës së Qafës së Morinës (1.385 m.), dhe vazhdon përgjatë shtratit të Përroit Dragiq deri te kufiri me Serbinë, për të vazhduar në vijën kufitare me Malin e Zi dhe Shqipërinë, ku edhe mbyllet kufiri. Mbi 90% e territorit të Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” – shtrihet në komunat Istog, Pejë, Deçan dhe Junik, territor mbi të cilin Prokuroria Themelore në Pejë ushtron kompetencën territoriale.

Territori i shpallur Park kombëtar me emrin Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, si tërësi hapësinore veçohet me vlera dhe raritete natyrore, me numër të madh të ekosistemeve të rëndësishme pyjore dhe ekosisteme të tjera të ruajtura, me numër të konsiderueshëm të llojeve endemike dhe relikte, me karakteristika të pasura gjeomorfologjike, hidrologjike dhe peisazhore që kanë rëndësi shkencore, edukativo–arsimore, kulturore – historike, rekreative - turistike dhe veprimtaritë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik sipas kriterëve mjedisore.²

Sikurse dihet pyjet më të rëndësishme në Republikën e Kosovës, gjenden në këtë pjesë siç u përshkrua më lart dhe për shkak të kualitetit që kanë pyjet e kësaj ane janë edhe më të atakuarat nga prerësit ilegal dhe çdo prerje e pyjeve

² Shih neni 1, Ligji nr. 04/L – 086, për parkun kombëtar “BJESHKËT E NEMUNA”, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 2/21 Janar 2013.

kthen prapa disa dekada ekosistemin pyjor, pasi ripërtëritja e tyre është shumë e ngadalshme ndërsa pasojat janë zvogëlimi i sipërfaqes së gjelbër, më pak oksigjen të prodhuar dhe më pak dyokside karboni i harxhuar, prishje e kushteve mirkoklimatike të rajonit të caktuar, prishje e bilancit ujorë të tokës, prishje e habitateve jetësore të bimëve e sidomos shtazëve, po ashtu më pak hapësira rekreacioni e pushimi për njeriun dhe shumë pasoja të tjera.



Harta e parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

Duke e parë gjendjen jo të mirë të mbrojtjes së pyjeve nga degradimi përkatësisht prerja e pakontrolluar, ka qenë e domosdoshme që të caktohet dhe

është caktuar një zyrtar përgjegjës dhe prokuror koordinator i cili do të ngarkohej me çështjet e mbrojtjes së pyjeve dhe ambientit në përgjithësi.

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit në luftimin e këtyre dukurive, janë mbajtur takime të vazhdueshme me institucionet përgjegjëse, policinë, përfaqësuesit nga Agjensioni pyjor dhe DAPK, për çka edhe vazhdimisht janë nxjerrë konkluzione të ndryshme të cilat do të ndihmonin në parandalimin e degradimit të pyjeve.

3.3.2. Të arriturat:

Sa i përket lëndëve të kësaj natyre, për veprë penale nga neni 338 janë pranuar 33 kallëzime kundër 38 personave, për veprë penale nga neni 346 janë pranuar 6 kallëzime penale kundër 6 personave, për veprë penale nga neni 348 janë pranuar 2 kallëzime penale kundër personave dhe për veprë penale nga neni 249 janë pranuar 70 kallëzime penale kundër 82 personave.

Nga lëndët e pranuarra për veprën penale nga neni 338 janë ngritur 32 aktakuza kundër 32 personave dhe 2 raste kundër 2 personave janë hedhur kallëzimet penale. për veprën penale nga neni 346 janë ngritur 6 aktakuza kundër 6 personave dhe 1 rast kundër 1 personi është dërguar në kompetencë. Për veprën penale nga neni 348 është ngritur 1 aktakuzë kundër 1 personit dhe 1 kallëzim penal kundër 1 personi është hedhur. Për veprën penale nga neni 349 janë ngritur 50 aktakuza kundër 57 personave, 1 rast është pezulluar hetimi, 1 rast me 7 persona është pushuar hetimit dhe 1 kallëzim penal me 4 persona është hedhur.

3.4. Sekuestrimet e përkohshme, ngrirjet e aseteve dhe konfiskimet

Me qëllim të zbatimit sa më efikas të parandalimit të dukurive dhe fenomeneve negative Prokuroria Themelore në Pejë ka vlerësuar se Instituti i sekuestrimit të përkohshëm të sendeve duhet aplikuar në mënyrë rigoroze me qëllim që aseti apo sendi i përfituar me kryerjen e veprës penale përkatësisht mjeti me të cilin është kryer vepra penale të nxirret përkohësisht jashtë qarkullimit dhe i njëjti të shërbejë si provë në procedurë penale.

PTH-Pejë gjatë vitit 2023, ka kërkuar nga Gjykata për 120 raste të lëshohen urdhrat për sekuestrim të përkohshëm.

Lidhur me veprat penale të vjedhjet së pyllit, këtë periudhë janë sekuestruar 5 kamion, një eskavator, 7 automjete, 3 traktor dhe një rimorkio e traktorit, 2 motorsharrë dhe rreth 260.7m³ drunjë të ndryshëm.

Kamion	Kombi	Automjete	Traktorë	Motorsharrë	Masë drusore
5	0	7	3	2	19.81 m

3.5. Zgjidhja e rasteve me procedurat alternative

Gjatë vitit 2023 janë përfunduar 184 raste kundër 277 personave. Prej rasteve të përfunduara DKR ka përfunduar 2 raste 2 personave nga neni 233, me marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, gjersa DP 182 raste kundër 275 personave, prej të cilave nga neni 232 janë kryer 180 raste kundër 272 personave, nga neni 233 është 1 rast me 2 persona dhe nga neni 230 është 1 rast kundër 1 personi

Procedura	Lindje	Persona
Neni 230	1	1
Neni 231	0	0
Neni 232	180	272
Neni 233	3	4
Gjithsej	184	277

4. Gjendja e rasteve në regjistrin PPN

Gjatë vitit 2023 në regjistrin PPN janë pranuar 1,415 lëndë, prej të cilave DKR ka pranuar 314 raste, PPNM 117 raste dhe DP 984 raste, ndërsa nga vitet paraprake janë bartur 1097 lëndë prej të cilave DKR 179 lëndë, DM 16 raste dhe DP 902 raste. Andaj në punë kishim 2,512 raste prej të cilave 493 raste në DKR, 133 raste në DM dhe 1886 raste në DP.

Kjo prokurori gjatë kësaj periudhe ka përfunduar 702 lëndë ashtu që DKR ka kryer 282 raste, DM 128 lëndë dhe DP 292 raste, gjersa si të pa kryera kanë mbetur 1,810 lëndë dhe atë në DKR 211 raste, DM 5 lëndë dhe DP 1,594 raste.

Departamentet	Të pranuar	Të Bartura	Gjithsej në punë	Të kryera	Të pa kryera
DKR	314	179	493	282	211
DM	117	16	133	128	5
DP	984	902	1886	292	1594
Gjithsej	1415	1097	2512	702	1810

Gjendja e regjistrit PPN

5. Gjendja e rasteve në regjistrin PPP

Sa i përket regjistri PPP në këtë vit janë pranuar 612 lëndë dhe atë në DKR 19 raste dhe në DP 593 raste, ndërsa nga vitet paraprake janë bartur 1189 lëndë dhe atë DKR 130 lëndë ndërsa DP 1059 lëndë, pra në punë ishin 1801 lëndë prej të cilave 149 lëndë në DKR dhe 1652 në DP.

Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar 41 lëndë prej të cilave DKR ka përfunduar 14 raste dhe 27 lëndë DP, ashtu që si të pa kryera kanë mbetur 1733 lëndë për çka DKR ka 135 lëndë ndërsa DP 1598 lëndë.

Departamentet	Të pranuar	Të Bartura	Gjithësej në punë	Të kryera	Të pa kryera
DKR	19	130	149	14	135
DP	593	1059	1652	27	1598
Gjithsej	612	1189	1801	41	1733

Gjendja e regjistrit PPP

6. Gjendja e rasteve në regjistrin NJN

Në lidhje me këtë regjistër janë pranuar 17 lëndë, nga viti i kaluar janë bartur 13 lëndë që do të thotë në punë kishim 30 lëndë prej të cilave janë kryer 22 gjersa në punë për vitin 2024 janë bartur 8 lëndë.

Vlen të ceket se me lëndët e kësaj natyre është marrë prokurorja Ersan Qavolli dhe në bazë të statistikave të pasqyruara rezulton se efikasiteti i trajtimit të këtyre lëndëve ka qenë shumë i mirë.

7. Zbatimi i SMIL-it PTH – Pejë

Sa i përket zbatimit të Sistemit elektronik për menaxhimin elektronik të lëndëve SMIL, mund të themi se, Prokuroria Themelore në Pejë gjatë vitit 2023 ka shënuar përparim në fushën e zbatimit të tij. Ky konstatim mbështetet në faktin se, në të gjitha raportet e gjeneruara dhe vlerësimi nga Komisioni më menaxhimin e SMILIT, kanë shënuar progres në raport me vitet paraprake.

Ky përparim është arritur falë angazhimit të zyrtares kompetente nga SMIL Blerina Shoshi e cila në vazhdimësi e ka mbikëqyrë punën rreth zbatimit rigoroz të SMIL-it në Prokurorinë Themelore në Pejë, me ç'rast arritjet janë shprehje edhe e bashkëpunimit të të punësuarve në Administratën e Prokurorisë përfshirë këtu edhe Prokurorët. Vlen të theksohet se, në prokurorinë Themelore në Pejë të gjitha veprimet procedurale punohen nëpërmjet SMIL-it pa asnjë përjashtim. Pra, zbatimi i programit SMIL në Prokurorinë Themelore në Pejë është njëra prej prioriteve kryesore.